

**Frashër DEMAJ**

## **RRETHANAT POLITIKE NË KOSOVË DHE SUPRIMIMI I AUTONOMISË (1989)**

### **Abstrakt:**

*Pas anulimit të vendimeve dhe Rezolutës së Konferencës së Bujanit, vendosjes së administrimit ushtarak, Kuvendit të Prizrenit dhe një varg vendimesh tjera politike, Kosova u vu nën administrim të plotë të Serbisë dhe Jugosllavisë. Pas Plenumit të Brionëve, Demonstratave të vitit 1968 dhe Kushtetutës së vitit 1974, statusi politik dhe juridik i Kosovës shënoi ngritje kualitative në të gjitha fushat. Situata politike dhe e sigurisë në Kosovë në prag të suprimimit të Autonomisë së Kosovës ishte shumë e ndërlikuar. Marrëdhëniet ndërnacionale sidomos në mes të shqiptarëve si shumicë dhe serbëve e malazezëve kishin rënë në pikën më të ulët. Rrënimi kundërkushtetues i pozitës së Kosovës të përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1974 u bë me një mori veprimesh dhe aktesh me motive politike. Që nga viti 1981, Republika e Serbisë, me bekimin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, përmes pushtetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës që dominohej në shumicë nga serbët dhe malazezët vazhdoi me fushatë denigruese, shpifëse dhe akuzuese ndaj shqiptarëve që kërkonin të drejtat e tyre kombëtare. Ardhja e Sllobodan Millosheviqit në pushtet në Serbi, rinovoi një agjendë të ringjalljes së nacionalizmit serb. Në Serbi u përhap një eufori nacionaliste. Kësaj shtate i shërbeu edhe Memorandumi i Akademisë së Shkencave dhe i Arteve të Serbisë (SANU-1986). Edhe shkrimtarët serbë u shndërruan në objekt të manipulimeve të politikës ditore duke ngritur zërin kundër kombeve*

*tjera. Në këtë fushatë luftënxitëse ndaj të tjerëve ishte implikuar edhe Kisha Ortodokse Serbe. Agresioni i hapur i serbëve ndaj shqiptarëve shpërtheu më 24 prill 1986 në tubimin e serbëve në Fushë-Kosovë ku ishte prezent Sllobodan Millosheviqi. Aty u inskenua një ndërhyrje e policisë ndaj turmave serbe. Millosheviqi e ndërpreu mbledhjen që po mbante me përfaqësuesit politikë, doli jashtë dhe iu drejtua turmës me fjalët: “Askush nuk guxon t’ju rrahë”. Ky moment shënon nisjen e ngritjes së hovshme të tij në karrierën politike në Serbi dhe Jugosllavi. Më 23 mars të vitit 1989, në Kuvendin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në kundërshtim me vullnetin e qytetarëve, u ndryshua Kushtetuta e vitit 1974, që nënkuptonte suprimimin e Autonomisë së Kosovës në Federatën Jugosllave. Më 28 mars 1989 në Beograd festohej shfuqizimi i Autonomisë së Kosovës dhe shpallej “unifikimi” i Serbisë, ndërsa në Kosovë vazhdonte edhe më tej torturimi, burgosja dhe vrasja e shqiptarëve, të cilët atëbotë manifestonin në mënyrë paqësore kundër shfuqizimit të të drejtave të tyre nga regjimi i Millosheviqit. Ndaj këtyre veprimeve çnjerëzore dhe antikushtetuese reagoi elita intelektuale e Kosovës që ishte pjesë e forumeve të ndryshme politike e jopolitike dhe opinionit i gjerë publik, i cili u solidarizua dhe përkrahu me forcë shfaqjen e pakënaqësisë qytetare përmes protestave paqësore në të gjitha qytetet e Kosovës.*

**Fjalët kyçe:** *Kosova, shqiptarët, politike, suprimimi i Autonomisë, pushteti serb, nacionalizmi.*

### **Përcaktimi politik për vetëvendosje në Konferencën e Bujanit**

Shpresat e shqiptarëve të Kosovës për të realizuar të drejtat kombëtare ishin shtuar gjatë Luftës së Dytë Botërore kur ata u bënë pjesë e frontit të përbashkët e Luftës Antifashiste jo vetëm me popujt e Jugosllavisë, por pjesë e rëndësishme e koalicionit botëror që luftonte nazifashizmin. Shqiptarët e Kosovës ishin të bindur se duke qenë pjesëmarrës të barabartë me të tjerët në këtë luftë dhe bazuar në dokumentet ndërkombëtare që nënshkruan Aleatët e Mëdhenj, Kosovës do t’i takonte e drejta për vetëpërcaktimin e statusit të saj

final. Përkrahësit e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në Kosovë besonin se Partia Komuniste e Shqipërisë, por edhe komunistët shqiptarë të Shqipërisë si dhe ata të Kosovës do të zbatonin pas lufte parimin e proklamuar për të drejtat e popujve dhe të vetëvendosjes deri në shkëputje.<sup>1</sup> Pra, mbi bazën e marrëveshjes për luftë të përbashkët dhe të drejtën e popujve për vetëvendosje i zhvilloi punimet edhe Konferenca e Parë e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar për Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit ose Konferenca e Bujanit.

Konferenca u mbajt më 31 dhjetor 1943 e deri me 2 janar 1944, në kullën e Sali Manit, Bajraktarit të Krasniqes në Bujan të Malësisë së Gjakovës. Aty ndodhej edhe Shtabi Kryesor i UNÇ-së së Kosovës dhe Komitetit Krahinor për Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit. Në këtë mbledhje nga 61 delegatë të ftuar, morën pjesë 49 (6 serbë e malazezë) që përfaqësonin të gjitha viset dhe shtresat shoqërore të Kosovës. Pra, 12 delegatë të ftuar nuk kishin arritur me kohë në Konferencë për shkak të kushteve të vështira, të cilat ishin krijuar si shkak-pasojë e zhvillimeve të Luftës së forcave antifashiste kundër forcave gjermane, të cilat kishin instaluar pushtetin e tyre ushtarak. Mirëpo, kjo mungesë nuk e pengoi mbarëvajtjen e punimeve të Konferencës, meqë kishte kuorum të mjaftueshëm në kuptimin e përfaqësimit të forcave antifashiste nga krahina të ndryshme dhe gjithëpërfshirja etnike e përbërjes së popullsisë së Kosovës.

Konferenca u mbajt pesë muaj pas Mbledhjes së Mukjes (1-2 gusht 1943), tre muaj pas formimit të Lidhjes së Dytë të Prizrenit (16-20 shtator 1943), dy muaj e gjysmë pas vendimit të Parlamentit të Shqipërisë për bashkimin e tokave shqiptare në Jugosllavi me shtetin e ri shqiptar (13 tetor 1943) dhe një muaj pas mbylljes së punimeve të

---

<sup>1</sup> Fehmi Rexhepi, *“Vendimet e Konferencës së Bujanit - frymëzim për pjesëmarrje aktive të shqiptarëve të Kosovës në Luftën Çlirimtare Antifashiste”*, botuar në: Konferenca e Bujanit, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1998, 32.

Mbledhjes II të AVNOJ-it në Jajcë të Bosnjë-Hercegovinës.<sup>2</sup> Pra, pjesëmarrësit e Konferencës ishin të informuar për zhvillimin e ngjarjeve brenda faktorit politik shqiptar dhe kundërthënieve midis tyre si dhe me zhvillimin e punimeve, marrë parasysh edhe vendimet e AVNOJ-it si forum politik që mbledhi përfaqësuesit e popujve të Jugosllavisë.

Konferenca zgjodhi Kryesinë prej 9 anëtarësh: Mehmet Hoxha (kryetar), Rifat Berisha (nënkryetar), Pavle Joviqeviqi (nënkryetar), Xheladin Hana (anëtar), Fadil Hoxha (anëtar), Hajdar Dushi (anëtar), Zekeria Rexha (anëtar), Milan Zeçarin (anëtar) dhe Ali Shukriun (anëtar).<sup>3</sup>

Punimet e Konferencës i hapi Xhevdet Doda, delegat i brigadës kosovaro-maqedonase, kurse fjalë përhëndetëse e mbajti Fadil Hoxha, komandant i SHK-së së UNÇ-së për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit; Pavle Joviqeviqi në emër të KK-së së PKJ-së për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit; Xhafer Vokshi në emër të Rinisë Antifashiste; Sabrije Vokshi në emër të grave antifashiste; përfaqësuesi i misionit ushtarak anglez në SHK të UNÇ-së e AP-së për Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit, majori Baily; Mehmet Bajraktari në emër të KNÇ-së së Krasniqes.<sup>4</sup> Gjatë dy ditëve sa zgjatën punimet e Konferencës u lexuan dy referate dhe pati diskutime nga delegatët e pranishëm. Njërin referat të titulluar “Situata politike dhe formimi i KKNÇ” e lexoi Mehmet Hoxha, ish-prefekt i Elbasanit, i cili theksonte frikën e shqiptarëve të Kosovës nga rikthimi eventual i regjimit të Jugosllavisë së vjetër, nga i cili kishin vuajtur shumë. Kurse referatin e dytë e lexoi Xhavit Nimani, i cili

<sup>2</sup> Sami Repishti, “*Një qasje për Rezolutën e Bujanit*” botuar në: Konferenca e Bujanit, Instituti i Historisë, Prishtinë 1998, 153; Ali Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë (1941-1945)*, Prishtinë, 1971, 333.

<sup>3</sup> Frashër Demaj, “*Mbledhja e Mukjes, Lidhja e Dytë e Prizrenit dhe Konferenca e Bujanit - të përbashkëtat dhe dallimet*”, botuar në: Roli i Konferencës së Bujanit në procesin e shtetformimit të Kosovës, ASHAK, Prishtinë 2024, 53.

<sup>4</sup> Ana Lalaj, “*Mbi Konferencën e Bujanit*”, botuar në *E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 1990, 375.

ishte sekretar i Komitetit të Rrethit të PKJ-së së Prizrenit dhe anëtar i Komitetit Qarkor të PKJ-së të Rrafshit të Dukagjinit. Drojën e rikthimit të dhunës dhe terrorit jugosllav në rast bashkëpunimi me UNÇJ-në dhe forcat politike PKJ-në e kishin shprehur edhe Bedri Pejani, Selman Riza, Xheladin Deda, vëllezërit Kryeziu, Ukë Sadiku, Kajtaz Ramadani etj.<sup>5</sup>

Dokumenti më i rëndësishëm i kësaj Konference ishte Rezoluta e Konferencës, e cila u miratua njëzëri nga të gjithë pjesëmarrësit e Konferencës. Në pjesën e parë të Rezolutës, konstatohet se në punimet e Konferencës kanë marrë pjesë përfaqësuesit e të gjitha viseve të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit: shqiptarët, serbët, malazezët, nacionalistët, komunistët, rinia antifashiste, përfaqësuesit e ushtrisë, të rinisë komuniste, përfaqësuesit e grave antifashiste etj., të frymëzuar nga ideali i lartë për bashkimin e tendencave të ndryshme politike.

Pa dyshim, pjesa më e rëndësishme e Rezolutës është ajo në të cilën shprehimisht thuhej:

*“Kosova e Rrafshi i Dukagjinit është një krahinë e banuar në shumicë nga populli shqiptar, i cili, si gjithmonë, ashtu edhe sot dëshiron të bashkohet me Shqipërinë. Prandaj e ndjejmë për detyrë t’i tregojmë rrugën e drejtë që duhet të ndjek populli shqiptar për t’i realizuar aspiratat e veta. Rruga e vetme, pra, që populli shqiptar i Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit të bashkohet me Shqipërinë është lufta e përbashkët me popujt tjerë të Jugosllavisë kundër okupatorit nazist gjakatar e rrogëtarëve të tij. Sepse kjo është e vetmja rrugë për ta fituar lirinë, në të cilën të gjithë popujt, pra edhe shqiptarët, do të kenë mundësi të vendosin për fatin e vet me të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje. Garanci për këtë është Ushtria Nacionalçlirimtare e Jugosllavisë dhe Ushtria Nacionalçlirimtare e Shqipërisë, me të cilën është ngushtësisht e lidhur. Përveç këtyre, për këtë garantojnë Aleatët*

---

<sup>5</sup> Izber Hoti, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Prishtinë dhe rrethinë 1941-1945*, Prishtinë 1986, 147.

*tanë të Mëdhenj: Bashkimi Sovjetik, Anglia e Amerika (Karta e Atlantikut, Konferenca e Moskës dhe ajo e Teheranit)*<sup>6</sup>.

Pra, Konferenca e Bujanit ishte përcaktim politik i përfaqësuesve të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar për Kosovë e Krafsh të Dukagjinit për të ardhmen dhe statusin politik të bazuar në të drejtën për vetëvendosje, e drejtë që buronte nga dokumentet ndërkombëtare dhe rreshtimi e kontributi i shqiptarëve të Kosovës në luftë kundër nazifashizmit.

### **Vendosja e administrimit ushtarak dhe aneksimi i Kosovës**

Vendimet e Konferencës së Bujanit, pjesëmarrja e përfaqësuesve serbë e malazezë si dhe miratimi i Rezolutës edhe nga ana e këtyre përfaqësuesve alarmoi qarqet nacionalshoviniste serbe, të cilat pretendonin ta mbanin Kosovën të pushtuar si pjesë të territorit të tyre edhe pas përfundimit të luftës. Pas kapitullimit të Gjermanisë dhe çlirimit nga pushtuesit nazifashistë, në Kosovë e vise tjera shqiptare depërtuan njësitet partizane serbo-malazeze-maqedonase të cilat ushtruan dhunë e terror në të gjitha krahinat e banuara me popullsi etnike shqiptare. Ushtria serbe kreu krime nga më të ndryshmet duke mos kursyer fshat as qytet, moshë as gjini, duke shënjestruar persona e familje të shquara patriotike shqiptare.

Këto veprime ishin vazhdimësi e përpjekjeve serbe për të defaktorizuar shqiptarët dhe të drejtën e tyre për vetëpërcaktim politik, futjen e frikës në popullsinë shqiptare të Kosovës dhe çarmatosjen e aradheve dhe brigadave shqiptare, me të cilët kishin luftuar së bashku në frontet e luftës në mënyrë që ata të mos mund të mbroheshin nga agresioni serb që po i përgatitej Kosovës. Për të finalizuar projektin antishqiptar u ndërmorën edhe veprime politike në mbështetje të dhunës së ushtruar ndaj shqiptarëve. Prandaj, më 8 shkurt 1945, me urdhrin e komandantit suprem Josip Broz Tito, me pretekst të shuarjes së “kundërrevolucionit” vendosi pushtetin e hekurt në Kosovë përmes

---

<sup>6</sup> Rezoluta e Konferencës së Bujanit, botuar në librin *Këshilli Popullor i Krahinës Autonome të Kosovës dhe Dukagjinit*.

administrimit ushtarak që dominohej nga serbët dhe malazezët.<sup>7</sup> Administrata ushtarake në krye të pushtetit të dhunshëm vendosi Sava Dreleviqin. Vendosja e administrimit ushtarak shërbeu si mburojë e qarqeve nacionalistë serbë të strehuar në platformën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe “vëllazërim-bashkimit” të popujve të Jugosllavisë. Në rrethana të reja politike, dhuna ndaj shqiptarëve mori dimensione të reja në gjithë territorin e Kosovës e sidomos në Drenicë, ku gjatë pranverës së vitit 1945 njësitet partizane të UNÇJ-së vranë e masakruan mijëra shqiptarë dhe dogjën e shkatërruan fshatra të tëra të populluara etnikisht me shqiptarë. Kulmi i krimeve serbe e jugosllave ndaj shqiptarëve arriti pikën më të lartë në Tivar më 1 prill 1945, ku u vranë dhe masakruan mijëra shqiptarë të mobilizuar, shumica prej të cilëve kishin marrë pjesë në Luftën e përbashkët Antifashiste, sepse kishin besuar se pas përfundimit të luftës dhe fitores mbi fashizmin secili popull do t’i realizonte të drejtat e veta kombëtare.

Pas këtyre veprimeve të njëanshme politike dhe ushtarake dhe të papranueshme për popullin shumicë të Kosovës, territori i saj mbeti nën hegjemoninë dhe diktaturën komuniste në kuadër të Serbisë. Për të përligjur pushtimin e Kosovës, udhëheqja shtetërore serbe e jugosllave në bashkëpunim me udhëheqjen partiake e ushtarake në Kosovë, e cila ishte krejtësisht në duart e kuadrove serbo-malazeze, organizoi më 8-10 korrik 1945 në Prizren Konferencën e Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës e të Dukagjinit. Në këtë Konferencë morën pjesë 142 delegatë dhe të ftuar, shumica e të cilëve ishin serbë e malazezë, por kishte edhe shqiptarë të mashtruar dhe të tjerë që nuk kishin legjitimitet dhe nuk i përfaqësonin interesat e popullit shqiptar në Kosovë. Kuvendi u mbajt në rrethana të jashtëzakonshme dhe miratoi rezolutën e hartuar në Beograd, në të cilën thuhej se “delegatët e Këshillit Krahinor të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit shprehen

---

<sup>7</sup> Më gjerësisht shih: Stipe Mesiq, *Si u shkatërrua Jugosllavia*, Prishtinë 2011.

vullnetin e tyre për t’iu bashkuar Serbisë”.<sup>8</sup> Vendimet e marra në këtë kuvend patën pasoja politike dhe shoqërore të pallogaritshme, sepse kufizuan të drejtën e popullit të Kosovës për vetëvendosje dhe aneksimin përfundimtar të Kosovës nga Serbia.

### **Demonstratat e vitit 1968**

Situata në Kosovë që nga paslufta e deri në vitin 1966 u karakterizua me dhunimin e pashembullt të drejtave qytetare e kombëtare të shqiptarëve të Kosovës. Kulmi i terrorizimit të kësaj popullsie ishte veçanërisht gjatë aksionit të mbledhjes së armëve në vitin 1956 ku në mënyrë barbare pothuajse u rrah e u torturua në mënyrat më ç’njerëzore një popull i tërë. Më 1 korrik 1966, në ishullin e Brioneve në Kroaci, filloi punimet Plenumi IV i Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë apo siç njihet ndryshe Plenumi i Brioneve, në të cilin u morën një varg vendimesh të rëndësishme.<sup>9</sup>

Pas Plenumit të Brioneve dhe rënies së Aleksandër Rankoviqit, dhuna ndaj shqiptarëve nuk u ndërpre, por u reduktua krahasuar me periudhën para Plenumit. Dy vjet më vonë, në vitin 1968 në Kosovë shpërthyen demonstratat e shqiptarëve në të cilat u shtruan kërkesa politike për statusin e shqiptarëve dhe të Kosovës. Në Prizren, Suharekë dhe Pejë u organizuan demonstrata, të cilat u zgjeruan më 27 nëntor në Prishtinë, në Gjilan, në Ferizaj dhe në Podujevë. Demonstrata më masive u organizua në Prishtinë ku u tubuan shqiptarët nga të gjitha komunat e Kosovës, por edhe qytete dhe fshatra nga Maqedonia dhe Mali i Zi. Kërkesat kryesore të demonstruesve ishin: “Kosova Republikë”, “Kushtetutë”, “Duam universitet”, “Vetëvendosje”, “Rroftë flamuri kuq e zi”, “Rroftë

---

<sup>8</sup> Arsim Bajrami, “*Parimi i vetëvendosjes nga Konferenca e Bujanit e deri te Deklarata e Pavarësisë së Kosovës*”, botuar në: Roli i Konferencës së Bujanit në procesin e shtetformimit të Kosovës, ASHAK, Prishtinë 2024, 83.

<sup>9</sup> Jusuf Bajraktari, *Plenumi i Brioneve dhe jehona e ndikimi i tij në Kosovës*, Universiteti i Kosovës, Fakulteti Filozofik, punim magjistrature, Prishtinë 1981, 63.

populli shqiptar”, e shumë parulla të tjera.<sup>10</sup> Republika si synim politik do të shënonte barazimin e nivelit politik, juridik dhe kushtetues të Kosovës me republikat tjera në Jugosllavi. Përtej statusit të Republikës shumë demonstrues dhe anëtarë të organizatave ilegale, në programet e tyre politike kishin për synim bashkimin e Kosovës me Shqipërinë.

Demonstratat e vitit 1968 nxorën në shesh problemin e madh shqiptar në Jugosllavi, që deri atëherë ishte kamufluar përmes propagandës shtetërore dhe nga frika që mbizotëronte ndër shqiptarë për shkak të dhunës së ushtruar ndaj tyre. Dhuna shtetërore serbe dhe jugosllave ndaj shqiptarëve u karakterizua me të vrarë dhe të plagosur, të arrestuar, të burgosur, të dëbuar nga puna dhe të detyruar të largohen nga Kosova drejt vendeve perëndimore. Nga ana tjetër edhe efektet qenë të jashtëzakonshme, sepse mbi bazën e kërkesave të shqiptarëve të manifestuara me kërkesa nga tubimet protestuese u shpejtua themelimi i Universitetit, u miratua Kushtetuta e Kosovës e vitit 1974<sup>11</sup> si bazë e rëndësishme juridiko-politike, e cila krijoi hapësirë për veprim politik mbi bazën e të cilit u themelua Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, u hapen Instituti i Historisë dhe Instituti Albanologjik, u rrit veprimtaria botuese, kulturore, shkencore dhe arritje tjera në shumë fusha të jetës.

### **Kushtetuta e vitit 1974 - Kosova element konstituiv i Federatës Jugosllave**

Trajtimi më serioz dhe përmbytësor i kërkesave politike, shoqërore dhe ekonomike të shqiptarëve shënoi ngritje cilësore pas demonstratave, të cilat ishin sinjal i qartë se pushteti komunist duhej të reflektonte, sepse çdo vonesë mund të prodhonte pasoja në stabilitetin politik dhe marrëdhëniet ndërnacionale në Kosovë. Në shkurt të vitit 1971, Kryesia e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, pasi shqyrtoi “Konkluzionet mbi çështjet shoqërore-ekonomike dhe politike të

<sup>10</sup> Shkodran Imeraj, *Kosova 1968-1990*, Instituti i Historisë - Prishtinë, 2021, 55.

<sup>11</sup> Gazeta Zyrtare e KSAK, nr. 4, 24 shkurt 1974.

Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës” i aprovoi ato<sup>12</sup>. Në këto konkluzione u theksua se “Është e domosdoshme që të bëhet një hap më tutje në drejtim të ndërtimit të Federatës si funksion i shtetësisë dhe i sovranitetit të secilës republikë dhe i autonomisë së krahinave, si mbështetje e barazisë së kombeve dhe e kombësive”, të cilat sipas pushtetit jugosllav i gëzonin të drejtat e barabarta.<sup>13</sup>

Ndërkohë, Kuvendi federativ e formoi komisionin për ndryshimet në amendamentet kushtetuese. Kuvendi më 30 qershor 1971, aprovoi amendamentet XX-XLII të Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të cilat krijuan mundësinë që krahinat autonome si KSA e Kosovës dhe KSA e Vojvodinës të kishin më shumë të drejta autonome dhe më shumë kompetenca në përfaqësim në instancat federative dhe në institucionet ekonomike, të sigurisë, sociale, kulturore, arsimore të krahinava.<sup>14</sup>

Komisioni Koordinues i Kuvendit të Republikës Federative të Jugosllavisë me në krye Eduard Kardelin, në fillim të vitit 1973, hodhi në diskutim publik projektin e ri të Kushtetutës së Republikës Federative të Jugosllavisë. Ky Komision përfundoi punën dhe më 21 shkurt 1974, duke i hapur rrugë miratimit të Kushtetutës së re në Kuvendin e Republikës Federative të Jugosllavisë. Këto veprime krijuan një situatë të re politike, e cila rezultoi me miratimin e akteve politiko-juridike të cilat i hapen rrugë zhvillimeve shoqërore e politike për të cilat prej kohësh kishte proklamuar elita politike jugosllave që fliste për “vëllazërim-bashkim” dhe të drejta të barabarta midis popujve. Pas miratimit të Kushtetutës së re të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë më 21 shkurt 1974, u hap perspektiva politiko-juridike që edhe republikat dhe krahinat të miratonin kushtetutat e tyre të reja. Kështu më 27 shkurt 1974, Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në mbledhjen e të gjitha

<sup>12</sup> Radoshin Rajović, *Autonomia e Kosovës*, Prishtinë, 1978, 433.

<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> Shkodran Imeraj, *Kosova 1968-1990 ...*,110.

dhomave miratoi Kushtetutën e parë të Kosovës.<sup>15</sup> Ky akt u konsiderua si arritje cilësore që hapte perspektivë politike për shqiptarët si popullsi shumicë dhe komunitetet tjera etnike në Kosovë.

Kushtetuta e re e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës kishte gjithsej 402 nene dhe këtë strukturë: Parimet themelore; pjesën e parë - Dispozitat e përgjithshme; pjesën e dytë - Rregullimi shoqëror; pjesa e tretë - Organet e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës; pjesa e katërt - Ndryshimi i Kushtetutës Socialiste Autonome të Kosovës; pjesën e pestë - Dispozitat kalimtare dhe të fundit.

Bazuar në Kushtetutën e re të Kosovës, u themeluan institucione të rëndësishme politiko-shoqërore, si: Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Kryesia e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Këshilli i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.<sup>16</sup> U themeluan edhe organet dhe nivelet e gjyqësisë kosovare, si: Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Gjykata Supreme e Kosovës, Prokuroria Publike, Gjykata e Punës së Bashkuar e Kosovës si dhe Avokati Shoqëror i Vetëqeverisjes.<sup>17</sup>

Miratimi i Kushtetutës së vitit 1974 e vazhdoi procesin e avancimit të pozitës kushtetuese të Kosovës në kuadër të RSFJ-së. Bazuar në dispozitat kushtetuese, Kosova u përcaktua si njësi autonome politike e territoriale dhe kjo i mundësoi të ishte element konstituiv i Federatës Jugosllave.<sup>18</sup> Pra, Kushtetuta e vitit 1974 shënon nivelin më të lartë të ngritjes cilësore të statusit dhe kushtetutshmërisë e ligjshmërisë së Kosovës brenda Federatës Jugosllave që në shumë

---

<sup>15</sup> Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Kosovës, (më tej: *ASHAK*), Fondi: Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Dokumenti KK. Nr.010-8, Prishtinë, 27 shkurt 1974.

<sup>16</sup> Arkivi i Institutit të Historisë-Prishtinë (më tej: *AIHP*), Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, miratuar më 27 shkurt 1974.

<sup>17</sup> Po aty.

<sup>18</sup> Arsim Bajrami, “*Zhvillimi i konstitucionalizmit në Kosovë*”, botuar në: *Zhvillimi i konstitucionalizmit shqiptar 1912-2024*, ASHAK, Prishtinë 2024, 51.

sfera të jetës ishte e barabartë me republikat tjera, por natyrisht që në kuadrin e hibriditetit kushtetues i mungonin disa të drejta të avancuara që i kishin republikat. Përfundimisht, Kosova sipas kësaj kushtetute ishte njësi federale dhe element konstituiv i shtetit që përbëhej nga gjashtë republika dhe dy krahina autonome.

### **Demonstratat e vitit 1981 dhe acarimi i situatës në Kosovë**

Shqiptarët e Kosovës pavarësisht nga ngritja e nivelit të autonomisë politike nuk ishin të kënaqur me trajtimin e tyre dhe me statusin e Kosovës. Prandaj ata nuk reshtën së kërkuari përmes protestave dhe demonstratave të drejta të tyre politike e kombëtare. Në vazhdimësinë e padëgjueshmërisë qytetare në Prishtinë më 11 mars 1981, në Mensën e Studentëve të Universitetit të Prishtinës, shpërtheu një pakënaqësi për ushqimin që ju servohej atyre, e cila më vonë u shndërrua në revoltë qytetare. Studentët demonstrues, nga Qendra e Studentëve të Universitetit të Prishtinës, të tubuar në grupe, depërtuan deri para ndërtesës së Radio Prishtinës në qendër të qytetit të Prishtinës, me qëllim të manifestimit të pakënaqësisë qytetare dhe masivizimit të protestuesve me qytetarë të zakonshëm.

Në situatën e acaruar politike, më 26 mars të vitit 1981, në Prishtinë do të vinte stafeta e Titos. Rinia studentore shqiptare e brumosur me ide nacionale në kërkim të perspektivës së Kosovës e akuzonte kryetarin Tito për mohimin e të drejtës së Kosovës dhe shqiptarëve për të qenë plotësisht i barabartë me popujt dhe republikat tjera të Jugosllavisë. Një natë përpara një grup studentësh të Universitetit të Prishtinës, në mbrëmjen e 25 marsit të vitit 1981, në Konviktin Nr. 3, në dhomën 403, morën vendim që me rastin e ardhjes së stafetës së Titos në Prishtinë, të organizohet një demonstratë në shenjë të kundërshtimit dhe shfaqjes së pakënaqësisë. Më 26 mars, në ora 10:00, në oborrin e Qendrës së Studentëve të Universitetit të Prishtinës, filluan të tuboheshin një numër i madh i studentëve shqiptarë.<sup>19</sup> Njësitët policore të Sekretariatit të Punëve të Brendshme

---

<sup>19</sup> Shkodran Imeraj, *Kosova 1968-1990...*, 120.

kishin marrë urdhër për të penguar studentët dhe qytetarët protestues. Ata ushtruan dhunë mbi demonstruesit në Qendrën e Studentëve të Universitetit të Prishtinës, për të penguar marshimin për te Teatri Krahinor, në qendër të qytetit të Prishtinës ku po zhvillohej ceremonia e stafetës së Titos.

Në këtë situatë të paqëndrueshme, Prishtina u vu nën shtettrrethim me njësi policore të ardhura në përforsim. Policia shpërndau protestuesit dhe shtypi brutalisht Demonstratat e 26 marsit të vitit 1981. Bilanci i përleshjes së demonstruesve me policinë ishte 23 demonstrues dhe 12 policë të lënduar dhe 12 demonstrues të arrestuar.<sup>20</sup>

Demonstratat e studentëve vazhduan edhe më 1, 2 dhe 3 prill të vitit 1981.<sup>21</sup> Gjatë këtyre ditëve u hodhën parulla dhe brohoritje të sinkronizuara, si: “Rroftë klasa punëtore - poshtë borgjezia”, “Bashkimi i të gjitha viseve shqiptare, jemi shqiptarë jo jugosllavë”, “Trepça punon, Beogradi ndërton”,<sup>22</sup> “Kushte për studentë”, “Kushte për punëtorë”, “Çmimeve stop”, “Duam punë”, “Poshtë robëria, rroftë liria”, “Lironi të burgosurit”, “Kosova është e jona”, “Trepça është e jona”, “Duam vetëvendosje”, “Të gjithë shqiptarët jemi një”, “Jemi shqiptarë, s’jemi jugosllavë” si dhe ndër kërkesat kryesore që u brohorit ishte “Kosova Republikë”.<sup>23</sup> Në ditën e tretë të demonstratave, u organizuan protesta në shumë qendra të Kosovës në të cilat u brohoritën përafërsisht parullat e njëjta. Nga ndërhyrja e

---

<sup>20</sup> *Demonstratat e vitit 1981*, Vëllimi II, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës - Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012.

<sup>21</sup> *Kosova - vështrim monografik*, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2011, 243-244.

<sup>22</sup> Zenuni, *Lëvizja Popullore e Kosovës...*, 9.

<sup>23</sup> “Liria” - organ i marksist-leninistëve të Kosovës, Nr. 3, maj 1981; Shih më gjerësisht: *Demonstratat e vitit 1981*, Vëllimi I, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës - Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012; *Demonstratat e vitit 1981*, Vëllimi II, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës - Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012.

organeve të rendit rezultuan 17 policë dhe 15 demonstrues të plagosur, prej të cilëve 3 ishin në gjendje të rëndë.

Protestuesve në Prishtinë iu bashkuan me qindra studentë, nxënës dhe punëtorë të ndërmarrjeve të ndryshme, si: punëtorët e Ndërmarrjes Ndërtimore “Ramiz Sadiku”, ata të Termocentralit të Obiliqit, punonjësit e Minierës së Thëngjillit etj. Nga situata e krijuar, Kryesia e Republikës Socialiste të Serbisë, më 2 prill 1981, shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë. Drejtuesit më të lartë komunistë, duke filluar që nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, Republika Socialiste e Serbisë dhe Krahina Socialiste Autonome e Kosovës, u bashkërenduan në qëndrimet e tyre për të demaskuar dhe për të gjykuar demonstratat e shqiptarëve të Kosovës.<sup>24</sup>

Komiteti Qendror i Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, në një mbledhje të mbajtur më 5 prill 1981 në Beograd, doli me qëndrimin zyrtar duke i cilësuar demonstratat me karakter armiqësor. Ata e vlerësuan se parulla “Kosova Republikë” është armiqësore, kundërrevolucionare dhe në kundërshtim me rendin kushtetues të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.<sup>25</sup>

Demonstratat e marsit dhe prillit të vitit 1981 u shtypen me dhunë, por pakënaqësia e popullit të Kosovës u shtua edhe më shumë. Kërkesat e shqiptarëve për Republikën e Kosovës në kuadër të Jugosllavisë të shprehura në Demonstratat e vitit 1981 u marginalizuan nga ana e institucioneve të Republikës Socialiste të Serbisë dhe të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Përpyekjet e pushtetit ishin të orientuara kryesisht në aspekte të rëndësishme, të cilat do të pengonin depërtimin e informacionit dhe sensibilizimin e kërkesave të popullsisë shqiptare të Kosovës brenda Jugosllavisë. Organizatorët e demonstratave dhe intelektualët që

---

<sup>24</sup> Faruk Salihu, “Ngjarjet e vitit 1981 dhe ndikimi i tyre në gjendjen politike në Kosovës”, në Revista “Kosova”, Nr. 27, Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë, 168.

<sup>25</sup> Shih më gjerësisht: ASHAK, Fondi: Gazeta “Politika”, Beograd, 6 prill 1981.

shtronin kërkesa politike u akuzuan, u burgosën dhe u dënuan me burgim të rëndë. Shumë të tjerë u detyruan të kalonin në ilegalitet në Kosovë, por edhe të tjerë që u detyruan të kërkonin azil politik në vende të ndryshme evropiane, kryesisht në Gjermani, Zvicër, Belgjikë, Austri, Francë, Holandë, Itali etj. Me këto veprime pretendohet të ndëshkoheshin bartësit e këtyre ngjarjeve dhe të frikoheshin ata të cilët pretendonin të trasonin këtë rrugë.<sup>26</sup>

Serbia dhe Jugosllavia duke shfrytëzuar autoritetin e shtetit jugosllav propagandonin në dëm të integritetit dhe identitetit kombëtar të shqiptarëve në Kosovë dhe Jugosllavi duke i akuzuar ata si popull i paemancipuar e primitiv që kanë pretendime të denigronin Jugosllavinë dhe që kishin prirje me pretendime destruktive e seperatiste.<sup>27</sup> Pavarësisht shuarjes së dhunshme të demonstratave të shqiptarëve, viti 1981 shënon thyerjen e marrëdhënieve ndërnacionale në mes të shqiptarëve si popull shumicë dhe serbëve e malazezëve që përbënin pakicë nacionale në Kosovë dhe krijoi bindjen e shqiptarëve që ishin në rrugë të drejtë dhe nuk duhej të hiqnin dorë nga të drejtat e tyre që të jenë të barabartë me të gjithë popujt dhe republikat e Jugosllavisë.

### **Mitingu i serbëve në Fushë-Kosovë**

Ardhja e Sllobodan Millosheviqit në pushtet, ringjalli një agjendë agresive të nacionalizmit serb dhe forcimit të pozitave të tij politike jo vetëm në Serbi, por edhe në republikat dhe krahina ku jetonte komuniteti nacional serb. Në Serbi u përhap një fetishizim nationalist që ndërkohë arriti në pikën më të lartë kur serbët nationalistë filluan të manifestonin çuditërisht një superioritet krahasuar me popujt tjerë të Jugosllavisë.<sup>28</sup> Nacionalizmit serb i shërbeu edhe Memorandumi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve e

---

<sup>26</sup> Edita Tahiri, “*Diplomacia e Kosovës në periudhën e okupimit*”, Kumtesë e lexuar në Simpoziumin shkencor “Çlirimi i Kosovës”, mbajtur më 12 qershor 2009 në Prishtinë, 3.

<sup>27</sup> Po aty.

<sup>28</sup> Stefan Karastojanov, *Kosova (një analizë gjeopolitike)*, Shkup 2007, 197.

Serbisë (SANU 1986) që për fat të keq u shndërrua në instrument në duar të politikës nacionaliste.<sup>29</sup>

Përfshirja e Akademisë në diskursin nacionalist krijonte përshtypjen se në Serbi po mobilizoheshin rreth diskursit nacionalist të gjitha institucionet e këtij vendi. Edhe Shoqata e Shkrimtarëve të Serbisë u shndërrua në altoparlant të manipulimeve të politikës ditore duke ngritur zërin kundër kombeve tjera, pavarësisht se shkrimtarët do të duhej të ishin në shërbim të paqes dhe humanizmit.<sup>30</sup> Përtej mbështetjes nacionaliste Shoqata e Shkrimtarëve të Serbisë dhe disa udhëheqës të Lidhjes Komuniste në Beograd, kaluan në një pozicion agresiv duke akuzuar Lidhjen e Shkrimtarëve të Kosovës dhe kryetarin e saj, Ibrahim Rugovën, për nxitje të protestave e demonstratave të shqiptarëve dhe destabilizimit të Kosovës, me pretendim kinse frikësimin e serbëve dhe detyrimin për t'u shpërngulur nga Kosova me qëllim të arritjes së spastrimit etnik.

Kurse Rugova në kundërreagimin e tij konstatonte se "... nuk ka këtu asnjë nxitje, por kjo që po ndodh është kryengritje e popullit kundër dhunës, për shkak të dhunës, sepse populli i Kosovës lufton për të drejtat e tij."<sup>31</sup> Pra, populli shqiptar i Kosovës nuk kishte shfaqur synime nacionalshoviniste ndaj të tjerëve, por po ngrinte zërin e protestës paqësore kundër padrejtësive dhe akuzave që po i drejtoheshin atij. Agresion i hapur i Serbisë ndaj shqiptarëve shpërtheu më 24 prill 1986 në tubimin e serbëve lokalë të manipuluar, në Fushë-Kosovë ku ishte prezent Slllobodan Millosheviqi me bashkëpunëtorët e tij nga Serbia dhe i shoqëruar nga funksionarë krahinorë. Në mitingun e serbëve u inskenua një ndërhyrje e policisë ndaj turmave serbe për të krijuar pretekstin se serbët po dhunoheshin nga organet e rendit të cilat ishin të dominuara nga punonjës të rendit

<sup>29</sup> Janusz Bugajski, *Ngritja e Kosovës, artikuj dhe fjalime nga okupimi deri te pavarësia*, Prishtinë 2006, 23.

<sup>30</sup> "Veçer", Intervju z Ibrahimom Rugovo, "*Naj rečejo, da živim v diktaturi*" Maribor 22.4.1989.

<sup>31</sup> "L'Unita", Intervista a Ibrahim Rugova, "*Questa è una rivolta popolare, Belgrado non la vuole capire*", Roma, 30.3.1989.

me kombësi shqiptare. Në momentin e inskenimit, papritmas, Millosheviqi e ndërpreu mbledhjen që po mbante me përfaqësuesit politikë, doli jashtë dhe iu drejtua turmës me fjalët: “Askush nuk guxon t’ju rrahë”. Kurse turma e ngazëllyer me ovacione thërriste emrin e Slllobodan Millosheviqit. Me këtë situatë të inskenuar paraprakisht, synohej që të krijoheshin skena të stisura, të cilat i paraqisnin shqiptarët si dhunues, kurse serbët dhe malazezët si viktimat të politikës “shqiptaromadhe”. Por në fakt ishte krejtësisht e kundërta, sepse vetë Millosheviqi kishte ardhur në Kosovë dhe duke keqpërdorur pritjen e organeve krahinore po kërcënonte shqiptarët me tone populiste të nacionalshovinizmit serb të sprovuara dhe të njohura edhe më herët nga qarqet serbe, të cilat kishin për qëllim nënshtrimin dhe spastrimin etnik të Kosovës nga elementi demografik shqiptar.

Mitingu i Fushë-Kosovës shënon ngritjen së hovshme të tij në karrierën politike në Serbi dhe Jugosllavi që kulmoi me luftëra e gjakderdhje gjatë viteve të nëntëdhjeta.<sup>32</sup> Ky veprim iu dha zemër qarqeve nacionaliste serbe e malazeze në Kosovë, të cilët vazhdonin të hiqeshin si viktimat të “nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar” dhe ky ishte momenti kur Serbia përmes Millosheviqit zotohej të mbronte serbët dhe malazezët në Kosovë. Pavarësisht nga skenarët dhe inskenimet serbe, Millosheviqi duke shfrytëzuar situatën në Kosovë dhe duke i instrumentalizuar serbët lokalë u shndërrua në një lider të pakontestueshëm, me autoritet dhe i gjithëpushtetshëm që gradualisht filloi t’i neutralizonte edhe kundërshtarët e vet politikë në Serbi. Mitingjet nacionaliste serbe vazhduan edhe gjatë viteve në vijim, sidomos në përvjetorët e “Betejës së Kosovës” në të cilat u dëgjuan shumë parulla antishqiptare.<sup>33</sup> Pozicionimi i serbëve dhe malazezëve lokalë në anën e synimeve serbe në Kosovë në njërin anë dhe pretendimet e shqiptarëve për mbrojtjen e autonomisë dhe avancimi e

<sup>32</sup> Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë 1998, 356.

<sup>33</sup> Beteja e Kosovës e vitit 1389 ishte luftë në mes popujve ballkanikë dhe Perandorisë Osmane. Betejën e fitoi P. Osmane, kurse Millosheviqi dhe liderët serbë u munduan ta tjetërsonin duke e quajtur luftë serbo-osmane dhe e manipuluan skajshëm duke e keqpërdorur politikisht.

statusit të Kosovës acaruan deri në mosdurim marrëdhëniet ndërnacionale midis popullsisë shumicë dhe grupeve etnike serbe e malazeze.

### **Veprimet politike dhe antikushtetuese në drejtim të rrënimit të Autonomisë së Kosovës**

Pozita kushtetuese juridike e Kosovës, e përcaktuar me zgjedhjet kushtetuese të vitit 1974, u shndërrua në objekt të kritikave dhe të sulmeve nacionaliste dhe shoviniste serbe, sidomos pas vitit 1981.<sup>34</sup> Këto tendenca vinin si politikë e sanksionuar nga instancat e caktuara, që ishin përgjegjëse për hartimin e platformave rrënuese antishqiptare dhe përcilleshin në Kosovë përmes bartësve të funksioneve më të larta krahinore, që ishin kryesisht serbë dhe malazezë. Serbia kishte publikuar “Librin e kaltër”, në të cilin ishte përcaktuar strategjia e veprimit gradual politik, me synim rrënimin e mëvetësisë kushtetuese dhe politike të Kosovës. Për të mos u dukur si veprim i njëanshëm nacional, politika serbe synonte që në kuadrin e realizimit të politikave të saj të implikonte edhe nacionalitete të tjera, si boshnjakë, goranë dhe shqiptarë, të cilët ndërkohë filloi t’i quante si “shqiptarë të ndershëm”.<sup>35</sup>

Politika serbe gradualisht po e projektonte platformën nacionaliste për krijimin e “Serbisë së Madhe” dhe për pikënisje përcaktoi rrënimin kundërkushtetues të mëvetësisë politike-territoriale të Kosovës dhe vënien e saj nën administrimin dhe vartësinë e plotë të Serbisë. Në funksion të arritjes së këtij qëllimi politik, pushteti serb, krahas forcave nacionaliste e shoviniste instrumentalizoi tërë potencialin e vet politik, shkencor dhe profesional, të cilët i funksionalizoi duke krijuar një makineri të tërë për qëllime politike,

<sup>34</sup> Arsim Bajrami, “Aktet kushtetuese dhe politike të lindjes së Republikës së Kosovës”, botuar në “Institucionalizimi i Republikës së Kosovës” në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992, ASHAK, Prishtinë, 2022, 43.

<sup>35</sup> Pas vitit 1990, Serbia i quante “shqiptarë të ndershëm” ata shqiptarë që e kishin pranuar rrënimin e Autonomisë së Kosovës, kishin pranuar autoritetin e Serbisë mbi Kosovën dhe që i shërbenin shtetit dhe politikës serbe.

konfrontuese dhe luftënxitëse me shqiptarët dhe popujt e tjerë që jetonin në një shtet të përbashkët.

Për të arsyetuar projektin nacional-shovinist në opinionin publik dhe politik të republikave të tjera, Serbia filloi të shfaqte veten si “viktimë” brenda federalizmit jugosllav, ku asaj iu kishin bërë shumë padrejtësi. Por në të vërtetë, kjo ishte një manovër politike e Serbisë karshi republikave të tjera dhe krahinave autonome. Gjatë fazës së debateve kushtetuese në opinionin serb dhe në atë jugosllav, u plasuan tezat e pasakta dhe tendencioze mbi gjoja “pabarazinë e Serbisë me njësitë e tjera federale të Jugosllavisë, për shkak se në përbërjen e saj gjenden dy njësi autonome”, teza “mbi federalizmin e kësaj njësie federale” etj.<sup>36</sup> Teza të tilla Serbia i lansonte për të ndërtuar pretekstin e ndërhyrjes dhe përgatitjen e terrenit politiko-juridik për ndryshime kushtetuese. Gjithë luftën e saj, Serbia e bënte kundër Kushtetutës së vitit 1974, e cila ia kishte nxjerrë nga dora Kosovën dhe Vojvodinën, të cilat i konsideronte si pjesë të integritetit të saj brenda Jugosllavisë.

Me ardhjen në pushtet në Serbi të Sllobodan Millosheviqit, më 1986 në Beograd udhëheqja serbe nisi fushatën “Serbia unike - Federata e fortë”, e cila kishte për qëllim fillimin e ndryshimeve kushtetuese në Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë e miratuar më 1974 në dëm të Kosovës dhe Vojvodinës. Pas fillimit të fushatës “Serbia unike - Federata e fortë”, u bënë ndryshime në Kryesinë e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, ku në vend të Fadil Hoxhës u emërua Sinan Hasani, ndërsa në Kryesinë e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë u dërgua Ali Shukriu.<sup>37</sup> Kuvendi i RSFJ-së nën presionin e serbëve miratoi Rezolutën për dërgimin e grupeve kontrolluese serbe e jugosllave në Kosovë që do të mbikëqyrnin punën e sistemit juridik dhe të

---

<sup>36</sup> Arsim Bajrami, “Aktet kushtetuese dhe politike të lindjes së Republikës së Kosovës”..., 46.

<sup>37</sup> *Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës (1877-1999)*, Prishtinë: Instituti i Historisë i Kosovës - Qendra për Informim e Kosovës, 1997, 75-77.

administratës në lidhje me elementët armiqësorë të shqiptarëve të Kosovës.

Më 21 janar 1987 Kuvendi i RSFJ-së, aprovoi “Propozimin për fillimin e ndryshimeve kushtetuese në Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë”, të cilat do t’i hapnin rrugë ndryshimeve kushtetuese në republika dhe krahina. Kurse më 23 mars 1987, Dhoma Federative mori vendim për nisjen e ndryshimeve në Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.<sup>38</sup> Edhe Kryesia e Republikës së Serbisë vendosi për t’i paraqitur Kuvendit të saj, një propozim për ndryshimin e Kushtetutës së Republikës Socialiste të Serbisë. Kurse Kuvendi i KSA të Kosovës, në rrethana specifike dhe për shkak të “multietnicitetit” më 6 nëntor 1987, kërkonte për të gjetur një pajtueshmëri të plotë dhe të qëndrueshme si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë, në mënyrë që të mos eskalonte situata politikisht dhe të mos bëheshin veprime antikushtetuese të cilat e cenonin kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e RSFJ-së. Sidoqoftë nën presionin e situatës politike, më 6 nëntor 1987, Kryesia e Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës e dha pëlqimin për fillimin e ndryshimeve kushtetuese.

Më 11 janar të vitit 1988, Kuvendi i Republikës Socialiste të Serbisë, votoi në favor të fillimit të ndryshimeve kushtetuese dhe më pas këtë vendim ia dërgoi dy kuvendeve të Krahinave Socialiste Autonome, të Kosovës dhe Vojvodinës. Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në një mbledhje të gjerë të tri dhomave, më 2 shkurt 1988, votoi për fillimin e ndryshimeve kushtetuese të cilat dolën të jenë fatale, sepse kështu nisi procesi antikushtetues që synonte suprimimin e Autonomisë së Kosovës.<sup>39</sup> Presioni i pushtetit serb për rrënimin e pozitës kushtetuese të Kosovës përveç përmes institucioneve legjislative përdori edhe metoda politike dhe jopolitike

---

<sup>38</sup> Shih më gjerësisht: Nikë Gjeloši, *Zhvillimet politike e juridike në Kosovë pas vitit 1990*, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik, Departamenti i Shkencave Politike (disertacion i doktoratës), Prishtinë, 2005, 56.

<sup>39</sup> Shkodran Imeraj, *Kosova 1968-1990...*, 154.

të stërholluara deri në detaje. Përdorimi i metodave më të sofistikuara represive bazohej në:

1. presionin ideologjik partiak nëpërmjet diferencimeve dhe degradimeve publike të personaliteteve intelektuale dhe politike shqiptare që mbronin pozitën kushtetuese të Kosovës;

2. presionin nëpërmjet ndjekjeve, arrestimeve, burgosjeve dhe procedurave policore;

3. presionin mediatik, përmes mediave të shkruara dhe radiotelevizioneve;

4. akuzat dhe linçimi i njerëzve me ndikim në opinionin publik që ishin elitë intelektuale dhe politike;

5. trajtimi i shqiptarëve si qytetarë të rendit të dytë etj.<sup>40</sup>

Pra, veprimet politike dhe juridiko-kushtetuese të Republikës së Serbisë duke përdorur gjithë potencialin e vet politik dhe duke instrumentalizuar serbët, malazezët dhe komunitete tjera të vogla dhe duke i nxituar ata kundër shqiptarëve mund të kategorizohen në veprime antikushtetuese dhe me tendencë për të zhbërë autonominë politike dhe territoriale që KSAK-ut ia garantonte Kushtetuta e vitit 1974.

### **Apeli i 215 intelektualëve**

Situata e rëndë dhe zhvillimet në Kosovë nxitën reagimin e fuqishëm të popullit të Kosovës. Rolin prijës e morën mbi vete elita intelektuale e Kosovës, e cila mori guximin dhe filloi kundërshtimin e masave të Serbisë në Kosovë, përmes reagimeve qytetare në mbrojtje të vlerave qytetare dhe të drejtave politike të garantuara me kushtetutë. Të indinjuar nga veprimet represive shtetërore një grup i intelektualëve të Kosovës, ndërmorën iniciativën për hartimin dhe

---

<sup>40</sup> Gazmend Zajmi, “Çështja e Kosovës në kuadër të çështjes shqiptare si sfidë e madhe dhe madhore e kohës dhe ndaj kohës”, Prishtinë, Revista “E drejta” 1/96; Gazmend Zajmi, “Rrjedhat e konfliktësisë shqiptaro-serbe në rrafshin kushtetues të ish-Federatës multinacionale të Jugosllavisë”, Vjetari 1996, Prishtinë, 1996; Gazmend Zajmi, “Dimensionis of the Questions of Kosova in the Balcanes”, Prishtinë, 1994.

nënshkrimin e një Apeli ku do të bëhej thirrje për ruajtjen e Kushtetutës së vitit 1974, dhe mosprekjen e parimeve themelore të saj.

Në Apelin e 215 intelektualëve shqiptarë të Kosovës, i bëhej thirrje Kuvendit të Republikës Socialiste të Serbisë që të mos prekeshin parimet themelore të Kushtetutës së vitit 1974, të cilat e garantonin Autonominë e Kosovës dhe mirëqenien e popullit të saj. Po ashtu, ky Apel, iu drejtua edhe opinionit të gjerë politik e publik të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, ku u bëhej i njohur qëndrimi për mosndryshimin e thelbit të Kushtetutës së vitit 1974, duke tërhequr vërejtjen se veprimet e gabuara politike dhe ato antikushtetuese mund të prekin në thelb harmoninë dhe bashkëjetesën e republikave e krahinave dhe popujve që jetonin në Jugosllavi.<sup>41</sup>

Nënshkruesit e Apelit konstatonin me vetëdije të plotë se përmbajtja dhe vlera e pozitës kushtetuese të Kosovës përfaqëson në thelb përmbajtjen dhe vlerën kushtetuese të popullsisë së Kosovës dhe, si e tillë, vlerën e posaçme dhe emocionale të popullsisë shqiptarë të Kosovës. Në Apel thuhej se Kosova nuk është e as nuk mund të jetë një nacionale e cilitdo nacionalitet të saj as Kosovë mesjetare, as Kosovë paramesjetare, as Kosovës e raportit të forcave gjatë Luftës së Dytë Botërore, por Kosovë e Luftës Nacionalçlirimtare dhe e Revolucionit Socialist, pra, jo Jug i Serbisë ose Serbi e Vjetër, por Kosovë e të gjitha nacionaliteteve të saj, në çka edhe konsiston një nga komponentët më të rëndësishëm të individualitetit të saj. Intelektualët apelonin që Kuvendi i RS-së së Serbisë të aprovojë vetëm një pjesë të amendamenteve, që nuk kanë të bëjnë me ndryshimin e raporteve ndërmjet RS-së së Serbisë dhe krahinave socialiste autonome, ndërsa shqyrtimi i amendamenteve të tjera, që kanë të bëjnë me këto raporte, në kuptimin të saktësimi eventual të dispozitave përkatëse kushtetues, të bëhet në procedurën e përgatitjeve të kushtetutave të reja.<sup>42</sup>

<sup>41</sup> Grup autorësh, *Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*, Prizren, 2001, 384.

<sup>42</sup> Shkodran Imeraj, *Kosova 1968-1990...*, 158.

Në Apel ftohej opinionit i Jugosllavisë, që, me seriozitet e moment aktual, të marrë zemërçelur dhe afirmim të pozitës kushtetuese të Kosovës mbi bazën e parimeve themelore të Kushtetutës së RSFJ-së. Pra, i bëhej thirrje opinionit jugosllav që të reagonte lidhur me veprimet antikushtetuese me tendencë zhbërjen e Autonomisë së Kosovës të garantuar me Kushtetutën e vitit 1974.

Apeli mbyllej me ftesën drejtuar opinionit të Jugosllavisë që të përkrah qasjen dhe kërkesat e tyre në mbrojtje të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Intelektualët në Apel e mbanin përgjegjës edhe Kuvendin të KSA-së së Kosovës, nga i cili kërkonin të kryente obligimet dhe të luante rolin vendimtar për mbrojtjen institucionale të pozitës kushtetuese të Kosovës, në kuptim të mosdhënies së pëlqimit për cilindo amendament, me të cilin do të reduktoheshin në çfarëdo mase të drejtat dhe detyrat e KSA-së së Kosovës, përkatësisht kualiteti dhe shkalla e pavarësisë së tyre.<sup>43</sup> Apeli që mban datën 21 shkurt 1989 iu dërgua Kuvendit të RS-së së Serbisë, Kryesisë së RSFJ-së, Kryesisë së KQ të LKJ-së, kryesive të republikave dhe të krahinave, Kryesisë së Konferencës Krahinore të LSPP-së së Kosovës dhe mjeteve të informimit publik në Jugosllavi.<sup>44</sup>

<sup>43</sup> Zekeria Cana, *Apeli i 215 intelektualëve shqiptarë*, Prishtinë: Rilindja, 2001, 125-134.

<sup>44</sup> Nënshkruesit e Apelit: Agim Çavdërbasha, Abdyl Kadolli, Abdyl Rama, Abdullatif Fusha, Abdyl Krasniqi, Abdullah Vokrri, Adem Limani, Adem Rrusta, Agim Deva, Agim Vinca, Agni Dika, Agron Dobroshi, Agron Kërliu, Agron Krasniqi, Agron Pustina, Agush Beqiri, Ahmet Kelmendin, Ajri Begu, Ali Aliu (profesor), Ali Aliu (ekonomist), Ali Olloni, Ali Podrimja, Ali Zatriqi, Atdhe Gashi, Anton Çetta, Arsim Morina, Asene Agai, Avni Brovina, Avni Saphiu, Bajram Krasniqi, Bajram Kabashi, Basri Ibrahimimi, Bedri Bakalli, Behar Zogiani, Behxhet Krasniqi, Beqir Shkreli, Besim Bokshi, Binak Kastrati, Binak Kelmendi, Bujar Bukoshi, Burbuqe Pustina, Burim Hatipi, Dalip Limani, Dervish Rozhaja, Emine Gashi, Emine Halimi, Engjëll Berisha, Enver Maloku, Enver Mehmeti, Eqrem Basha, Elvin Ahmeti, Ejup Pllana, Esat Dujaka, Esad Mekuli, Eshref Biçaku, Eshref Osmani, Evliana Bajçinovci, Fadil Bujari, Faik Hima, Fatmir Dalladaku, Faton Agani, Faton Hoxha, Fazil Zylferi, Fehmi Agani, Fehmi Bojaxhiu, Fehmi Rexhepi, Fëllanza Gjinolli, Flamure Selimi, Flora Brovina, Gani Mulliqi, Gani Hoxha, Gazmend Kaçaniku, Gazmend Shaqiri, Gazmend Zajmi, Gani Bobi, Halil Ahmetaj,

Apeli i 215 intelektualëve ishte një akt qytetar i motivuar nga tendencat nacionaliste serbe për rrënimin e pozitës kushtetuese të Kosovës, i cili vuri në lëvizje intelektualët e profileve të ndryshme dhe qarqe akademike në Kosovës, të cilët me shqetësim të madh po i përcillnin ngjarjet që po ndodhnin në prag të heqjes së Autonomisë së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe ishin të përkushtuar që të mobilizonin forcat dhe mendjet e tyre për të penguar veprimet shoviniste të politikës serbe.

---

Halit Hoxha, Halit Ymeri, Hajrullah Gorani, Hajredin Ukelli, Hakif Bajrami, Hamide Latifi, Hasan Ahmeti, Hasim Salihu, Hiviz Islami, Hasan Arifi, Hysni Hoxha, Hyri Daka, Ibrahim Kadriu, Ibrahim Rexhepi, Ibrahim Rugova, Idriz Ajeti, Irfan Pashoja, Ismet Shaqiri, Isuf Berisha, Jusuf Bajraktari, Jusuf Buxhovi, Latif Islami, Liman Matoshi, Liman Rushiti, Lirim Shaqiri, Lulëzim Agai, Lumturie Gashi, Lutfi Dervishi, Mark Krasniqi, Malzllum Belegu, Mazllum Hasimja, Mehmet Emërllahu, Mehmet Gjata, Mehmet Gërguri, Mehmet Maxhunni, Mehmet Kraja, Mehmet Surdulli, Mensur Pozhegu, Muharrem Bajrami, Muharrem Bulliqi, Muharrem Kutllovci, Muharrem Jakupi, Muharrem Gashi, Muharrem Salihu, Muharrem Blakaj, Muslim Mulliqi, Muslim Abdyli, Mustafë Lecaj, Murat Blaku, Nagip Rexhepi, Nazim Qehaja, Nehat Islami, Nexhat Krasniqi, Nexhmi Hyseni, Nuri Bashota, Nusret Ramadani, Orhan Kubati, Osman Imami, Osman Zeka, Qamile Morina, Qazim Hyseni, Ramadan Bislimi, Ramadan Musliu, Ramadan Jashari, Ramë Myftari, Ramiz Abdyli, Ramiz Kelmendi, Ramush Rama, Ramush Tahiri, Raif Aliu, Rauf Dhomi, Remzije Belegu, Rexhep Ismaili, Rexhep Qosja, Rexhep Hoxha, Rexhep Shala, Riza Binishi, Ruke Beqiraj, Rrustem Berisha, Rrustem Rugova, Sabri Hamiti, Salem Lepaja, Sadri Bajraktari, Sadri Fetiu, Sali Ahmeti, Sali Krasniqi, Sahit Maliqi, Sami Beqiri, Sami Mejzinolli, Sami Piraj, Sehadete Mekuli, Sejdulla Hoxha, Selim Krasniqi, Simë Dobreci, Skënder Zogaj, Sylejman Aliu, Sylë Osmanaj, Shaban Gashi, Shaban Hasi, Shefqet Berisha, Shefqet Meha, Shefqet Lulaj, Shefqet Riza, Shkëlzen Maliqi, Shkëlzen Raça, Shpëtim Robaj, Shyqyri Galica, Talat Gjinolli, Talat Pallaska, Tafil Morina, Tahir Neziri, Tefta Ahmeti, Teuta Ejupi, Ymer Aliu, Ymer Bajra, Ymer Elezi, Ymer Koçinaj, Ymer Jaka, Vehap Shita, Veli Blakçori, Vesta Nura, Xhavit Bicaj, Xhavit Kuçi, Xheladin Shala, Xheladin Reçica, Xhemail Bajraktari, Xhemail Mustafa, Xhemail Rexhepi, Xhemil Bytyçi, Xhevat Hasani, Zana Bukoshi, Zenun Çelaj, Zehir Hamiti, Zejnel Kabashi, Zejnel Kelmendi, Zejnullah Rrahmani, Zekiria Cana, Zekë Gecaj, dhe Zeqirja Ballata.

## **Greva e minatorëve të Trepçës, 21-28 shkurt 1989**

Situata e rëndë në Kosovë dhe rrezikimi i subjektivitetit të saj u ndje në të gjitha shtresat shoqërore, ndërmarrjet publike, administrata e vendit, shëndetësia, universiteti e deri te Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Institucionet që funksiononin në kuadër të këtyre fushave u deklaruan hapur kundër ndryshimeve kushtetuese me qëllim suprimimin e Autonomisë së Kosovës. Edhe minatorët e Trepçës u deklaruan kundër këtyre ndryshimeve. Ata ishin të vendosur për të mbrojtur kushtetutshmërinë e Kosovës, sepse ata ishin të bindur se këto ndryshime do ta kthenin Kosovën në Serbi. Më 17 nëntor 1988, minatorët e turnit të tretë, iu bashkuan minatorëve të turnit të parë dhe marshuan në këmbë në drejtim të Prishtinës, për të shprehur mospajtueshmerinë dhe pakënaqësitë e tyre karshi tendencave serbe kundër Kosovës.<sup>45</sup>

Pas 52 kilometrave rrugë me këmbë, masës marshuese të minatorëve të Trepçës, iu bashkuan edhe shumë punëtorë të tjerë të ndërmarrjeve të ndryshme dhe qytetarë, kryesisht familjarë të minatorëve. Me të arritur në Prishtinë rreth 3 000 minatorë, punëtorë e qytetarë u tubuan në Palestrën e Sporteve “Boro e Ramizi”.<sup>46</sup> Reagime ndaj marshimit të protestës së minatorëve pati nga Kryesia e Serbisë dhe Kryesia e KSAK-së. Pavarësisht reagimeve, minatorët e Kombinatit “Trepça”, vendosën për të hyrë në grevë në shenjë pakënaqësie për shkak të zhvillimeve politike. Hyrja në grevë nga 20 deri 28 shkurti i vitit 1989, kishte vënë në lëvizje drejtuesit më të lartë komunistë të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, të cilët druhashin nga masivizimi i protestave e demonstratave dhe eskalimi i situatës.

Minatorët pas hyrjes në grevë i paraqitën kërkesat e tyre publike drejtuar institucioneve politike të Krahinës së Kosovës:

---

<sup>45</sup> Mustafë Haziri, *Greva e minatorëve të Trepçës në Stantërg (20-28 shkurt 1989)*, Prishtinë: Lidhja e Historianëve të Kosovës, 2011, 34. Shih më gjerësisht: Aziz Abrashi, Burhan Kavaja, *Epopeja e minatorëve të Trepçës*, Prishtinë, 1996, 19.

<sup>46</sup> Po aty, 36.

1. të mos preken parimet themelore të Kushtetutës së vitit 1974;
2. të merren në përgjegjësi propozuesit e Projektligjit mbi pensionimin e parakohshëm të punëtorëve të arsimit dhe të rishikohet Ligji mbi pensionimin e parakohshëm të xehetarëve;
3. të japin dorëheqje të parevokueshme Rrahman Morina (kryetar i Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës), Hysamedin Azemi (anëtar i Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës) dhe Ali Shukriu (anëtar i Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë). Arsyet e argumentet për këtë le të vijnë t'i dëgjojnë nga goja jonë, porosisin minatorët;
4. të vijnë në mesin e tyre Stipe Shuvari, Slllobodan Millosheviqi dhe nga një përfaqësues i të gjitha komiteteve qendrore të RS-së dhe të KK-së së LK-së së Vojvodinës;
5. të emërtohen organizatorët e tubimeve masive të xehetarëve në nëntorin e vjetëm. Nëse ka të tillë, atëherë organizatorët jemi të gjithë xehetarët, nënvizojnë ata;
6. të na jepet përgjigje pse u larguan nga funksionet që patën shokët Azem Vllasi, Kaqusha Jashari dhe Svetislav Dollasheviqi, pa vlerësime bazë;
7. kërkojmë që udhëheqësit e Kosovës t'i zgjedhë baza, përkatësisht klasa punëtore e Kosovës e jo burokracia e republikave të tjera;
8. kërkojmë që fati i shqiptarëve në Kosovë e Jugosllavi të shqyrtohet në Kombet e Bashkuara;
9. hedhim poshtë politikën diskriminuese të Slllobodan Millosheviqit, e cila na largon nga rruga e drejtë e shokut Tito;
10. njoftojmë strukturat krahinore, republikane e federative, por edhe mbar opinionin se derisa të mos plotësohen

kërkesat tona, ne nuk kemi ndërmend të dalim nga horizontet e zgafelles së Xeherores së Stari-Tërgut.<sup>47</sup>

Formulimi i kërkesave të minatorëve, që nuk i prekte parimet themelore e as kushtetutshmërinë e ligjshmërinë e Jugosllavisë ishte një veprim shumë i zgjuar politikisht, sepse evitonte çdo argument politik që mund t'i cilësonte ata si prishës të rendit publik e politik të RSFJ-së. Minatorët ishin të vendosur që të mos ndërpresin grevën pa u plotësuar kërkesat e tyre, të cilat i publikuan edhe me shkrim në ditën e katërt të grevës.<sup>48</sup> Mbyllja e minatorëve në zgafelle i alarmoi strukturat shoqërore e politike, sidomos shqiptarët nga të cilët kërkohej solidarizimi me bashkëkombasit e tyre.

Më 21 shkurt 1989, minatorët e ngujuar në horizontin e nëntë, i vizitoi Remzi Kolgeci, kryetar i Kryesisë së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Gjatë bisedës me grevistët, Remzi Kolgeci i luti ata që të dalin nga galeria dhe të dialogohet për të gjitha problemet që i kishin shtruar në formë të kërkesave. Megjithatë minatorët ishin të vendosur të qëndronin deri në përmbushjen e kërkesave të tyre të cilat i konsideronin të panegociueshme dhe të domosdoshme për t'u përmbushur.<sup>49</sup> Përkundër situatës së tendosur, në mbledhjen e 22 shkurtit të vitit 1989, Kryesia e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe Kryesia e Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, u shprehën të vendosura për ndryshimet kushtetuese pa marrë parasysh rezistencën dhe pakënaqësitë e shqiptarëve. Minatorët grevistët më 23 shkurt 1989, njoftuan për hyrjen në një formë tjetër të grevës, atë të urisë. Të bindur për këmbënguljen e grevistëve, Rrahman Morina, kryetari i Kryesisë së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, bisedoi me drejtuesit e Kombinatit “Trepça” në përpjekje për të gjetur një zgjidhje për situatën e tendosur.<sup>50</sup>

<sup>47</sup> Shkodran Imeraj, *Kosova 1968-1990...*; ASHAK, Fondi: Gazeta “Rilindja”, Prishtinë, 24 shkurt 1989, 9.

<sup>48</sup> Shih më gjerësisht: ASHAK, Fondi: Gazeta “Rilindja”, Prishtinë, 21 shkurt 1989, 9.

<sup>49</sup> ASHAK, Fondi: Gazeta “Rilindja”, Prishtinë, 22 shkurt 1989, 1.

<sup>50</sup> ASHAK, Fondi: Gazeta “Rilindja”, Prishtinë, 24 shkurt 1989, 8.

Greva e minatorëve në Trepçë vuri në veprim edhe mekanizmat e Federatës Jugosllave. Kështu më 24 shkurt 1989, në ditën e katërt të grevës, xehetarët në nëntokë i vizitoi Stipe Shuvari, i cili ushtronte detyrën e kryetarit të Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Në këtë takim, grevistët përsëritën kërkesën për mosprekjen e parimeve themelore të Kushtetutës së vitit 1974 dhe atë për dorëheqjen e treshes së udhëheqësve komunistë Rrahman Morinës, Husamedin Azemit dhe të Ali Shukriut. Grevistët po ashtu i kumtuan Stipe Shuvarit vendimin se nëse deri në ora 09:00 të datës 25 shkurt 1989, nuk japin dorëheqje treshja e udhëheqësve komunistë, ata kërcënuan për radikalizim të mënyrës së protestës.<sup>51</sup> Kështu më 27 shkurt 1989, drejtuesit komunistë: Rrahman Morina, Husamedin Azemi dhe Ali Shukriu, njoftuan për dorëheqjen nga postet e tyre politike.<sup>52</sup> Pas këtij akti, greva u ndërpre, por situata e përgjithshme mbeti shumë e acaruar dhe me tendenca të përkeqësimit të mëtejme.

### **Suprimimi i Autonomisë**

Kriza e marrëdhënieve ndërnacionale dhe tendencat politike kundërkushtetuese arritën në pikën më të lartë, pavarësisht nga kundërshtimet dhe protestat qytetare. Në rrethanat e përplasjeve të mëdha politike, më 23 mars të vitit 1989, në Kuvendin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në kundërshtim me vullnetin e shqiptarëve, u ndryshua në mënyrë antikushtetuese dhe të dhunshme Kushtetuta e vitit 1974. Me këto ndryshime u realizua agresioni politik e kushtetues i Serbisë në Kosovë, sepse me këtë akt u suprimua Autonomia e Kosovës e garantuar nga kjo Kushtetutë.<sup>53</sup>

Ditën e 23 marsit, në sallë të Kuvendit ishte krijuar një situatë e pazakontë, për shkak të prezencës së madhe të njerëzve

<sup>51</sup> ASHAK, Fondi: Gazeta “Rilindja”, Prishtinë, 25 shkurt 1989, 5.

<sup>52</sup> ASHAK, Fondi: Gazeta “Rilindja”, Prishtinë, 28 shkurt 1989, 1.

<sup>53</sup> Frashër Demaj, “*Sensibilizimi dhe ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës 1990-1996*”, botuar në “Kosova - rruga drejt lirisë”, në 20-vjetorin e çlirimit të Kosovës, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë, 2020.

jokompetentë dhe ligjërisht të paautorizuar për të qenë prezentë dhe për të ndërhyrë brenda sallës së Kuvendit. Këta persona të paftuar kishin ardhur si “mysafirë” dhe kishin zënë rendet e para të ulëseve të Kuvendit të Kosovës, me direktiva dhe të porositur nga qarqet serbe të cilat e kishin përgatitur terrenin për rrënimin e Autonomisë së Kosovës. Ndërsa çuditërisht, pas tyre kishin vendosur të ulëshin delegatët e Kuvendit. Kjo pamje krijonte përshtypjen që ishte një truk i mirorganizuar dhe i mirëplanifikuar nga ana e serbëve dhe e malazezëve të dirigjuar drejtpërdrejt nga Beogradi.

Numri i konsiderueshëm i “mysafirëve” të ftuar për qëllime të caktuara në sallë, ishte sinjal për vendime antikushtetuese dhe për mbivotim e për manipulime numrash nga ana e Serbisë. Nga dëshmitë e bazuara në stenogramet e asaj kohe, tendenca e manipulimit zbulohet nga Riza Lluka, delegat nga Peja. Lluka doli në foltoren e Kuvendit dhe kërkoi që të ndalohej votimi i “mysafirëve” dhe të lejohet të shprehet vullneti politik i delegatëve si përfaqësues të popullit të Kosovës. Por, kërkesa e tij fatkeqësisht nuk u arrit në tërësi.<sup>54</sup> Pas bindjeve të plota se politika serbe kishte kurdisur një situatë të pazakontë reagan edhe disa delegatë tjerë shqiptarë, që e ngritën dorën kundër heqjes së Autonomisë së Kosovës. Nga 190 delegatë të tri dhomave sa kishte atëherë Kuvendi i Kosovës, delegatët që votuan kundër ndryshimeve kushtetuese dhe suprimimit të Autonomisë së Kosovës, ishin: Riza Lluka, Melihate Tërmkollli, Shkëlzen Gusia, Ukë Bytyçi, Sadik Zuka, Remzi Hasani, Menduh Shoshi, Bajram Buçani, Mehdi Uka dhe Avdi Berisha. Dy delegatë thuhet se abstenuan, ndërsa 25-30 munguan, pra nuk morën pjesë në seancë për arsye personale.<sup>55</sup>

Veprimet antikushtetuese i dhanë mundësi Serbisë të shpallte “krijimin e Serbisë unike”, që nënkuptonte bashkimin e KSA-së së Kosovës dhe KSA-së së Vojvodinës me Republikën e Serbisë. Pesë

---

<sup>54</sup> Arsim Bajrami, “Aktet kushtetuese dhe politike të lindjes së Republikës së Kosovës”..., 48.

<sup>55</sup> Më gjerësisht: Melihate Termkollli, *Marsi i acartë*, Prishtinë, 2022.

nene të Kushtetutës së Serbisë (108-112) trajtonin “Krahinën Autonome të Kosovës e të Metohisë” dhe “Krahinën Autonome të Vojvodinës”.<sup>56</sup> Pra, Kosovës iu ndryshua arbitrarisht edhe emri, duke i shtuar prapashtesën “Metohi”. Kosovës, me këtë rast, iu hoqën shumë të drejta kushtetuese dhe ndër të më të rëndësishmet ishin: policia, planifikimi ekonomik, drejtësia, mbrojtja territoriale dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.<sup>57</sup>

Në këto rrethana, përderisa në Beograd festohej, në Kosovë shqiptarët po manifestonin indinjatën dhe kundërshtimin e tyre përmes protestave dhe demonstratave. Ndërhyrja brutale e policisë ndikoi që këto protesta të rezultonin me shumë të arrestuar, të marrë në biseda informative, të rrahur dhe të burgosur shqiptarë. Ata trajtoheshin nga policia, sigurimi shtetëror serb dhe instanca të tjera të ndjekjes në mënyrat më çnjerëzore. Qëllimi ishte që të arrestuarit dhe të burgosurit të pranonin se u takonin grupeve të ndryshme ilegale nacionaliste e separatiste, që luftonin për prishjen e “bashkim-vëllazërimit”, kundër “shtetit ligjor të Serbisë dhe Jugosllavisë”.<sup>58</sup> Ndaj këtyre veprimeve çnjerëzore dhe antikushtetuese reagoi elita intelektuale e Kosovës, që ishte pjesë e forumeve të ndryshme politike e jopolitike dhe opinioni i gjerë publik, i cili u solidarizua dhe përkrahu me forcë shfaqjen e pakënaqësisë qytetare përmes protestave në të gjitha qytetet e Kosovës. Kurse serbët dhe malazezët e Kosovës, në vend të solidarizimit dhe të reagimit kundër dhunës, u vunë në

---

<sup>56</sup> Geert-Hinrich Ahrens, *Diplomacia mbi tehun e thikës, Pengimi i konfliktit etnik dhe Grupi i Punës për minoritetet i Konferencave për Jugosllavinë*, Tiranë 2010, 312.

<sup>57</sup> “Der Spiegel”, Interview mit Ibrahim Rugova, “Die serben kommen als Rächer wieder”, nr. 26, Hamburg 1989.

<sup>58</sup> Raportet e KMDLNJ-së për shkeljen e lirive dhe të drejtave të shqiptarëve nga ana pushtetit të Serbisë dhe Jugosllavisë në Kosovë; KMDLNJ është formuar më 14 dhjetor 1989 nga një grup i veprimtarëve për të drejtat e njeriut në Kosovë.

shërbim të politikës ditore, duke përkrahur masat e dhunshme policore ndaj qytetarëve shqiptarë.<sup>59</sup>

Suprimimi i Autonomisë së Kosovës ngjalli indinjatë dhe shqetësim në mesin e popullsisë shqiptare, sepse rrënimi i rendit kushtetues nënkuptonte shkatërrimin e Autonomisë së Kosovës dhe instalimin e dhunshëm të Serbisë në Kosovë, përmes eksponentëve minoritarë, kryesisht serbë e malazezë, duke përfshirë edhe emra nga komuniteti boshnjak, goran, turq dhe disa “shqiptarë të ndershëm” të cilët për popullin shqiptar konsideroheshin tradhtarë të interesave të Kosovës dhe të atyre kombëtare. Suprimimi i Autonomisë së Kosovës e rëndoi edhe më shumë situatën dhe i detyroi shqiptarët që të organizoheshin për të krijuar institucionet dhe sistemin e tyre të pavarur që nisen me Deklaratën Kushtetuese të 2 korrikut (1990), Kushtetutën e Kaçanikut, Referendumin për Kosovën Shtet Sovran dhe të Pavarur (1991) dhe mbajtjen e zgjedhjeve të para parlamentare dhe presidenciale (1992), të cilat rezultuan me formimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

---

<sup>59</sup> Frashër Demaj, *“Qëndrimi i politikës ndërkombëtare ndaj çështjes së Kosovës në fillim të viteve të ‘90-ta”*, botuar në “Institucionalizimi i Republikës së Kosovës në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992”, ASHAK, Prishtinë, 2022, 139.